



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 8 prill 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Enis Kervan, Shaip Muja, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi dhe Amir Ahmeti, kurse munguan: Hydajet Hyseni, Skënder Hyseni dhe Petar Miletic.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Shefki Kastrati, Luz Balaj, Rinor Beka - NDI, Besnik Ramadani – KDI, Sanije Berisha – OSBE, Ervin Ibrahim – UNDP, Arbënor Dehari asistent i nënkryetarit dhe Dafina Isufi e Besarta Hajdari - studente të Fakultetit Juridik.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 30 marsit 2011;
3. Njoftimi dhe raportimi i zëvendëskryeministres, Edita Tahiri, për bisedimet me Serbinë;
4. Të ndryshme.

Albin Kurti - Propozoi që Komisioni ta fillojë punën me pikën e tretë të rendit të ditës dhe pas përfundimit të saj të vazhdohet me pikat e tjera të rendit të ditës.

Shaip Muja - Bëri vërejtje në ftesën, me të cilën është ftuar zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri, në Komision, përkatësisht për formulimin “kompromiset e bëra atje”. Shtoi se për shkak të këtij formulimi do të abstenojë në shqyrtim e kësaj pike. Këtë formulim e konsideron qëndrim të kryetarit të Komisionit dhe lëshim të rëndë të Sekretarisë.

Sabri Hamiti - Tha se rendi i ditës, që është shpërndarë, është në rregull dhe mund të procedohet me këtë pikë.

Albin Kurti – Vuri në pah se ftesën për znj. Tahiri e ka formuluar vetë. Shtoi se me kompromis, në këtë rast, është menduar për kopjet e regjistrave civilë, për të cilët është raportuar në media dhe nuk është demantuar.

Shaip Muja - Raportimet e mediave nuk janë vendime zyrtare, kurse vendimet e Qeverisë dhe të Komisionit, që e përfaqëson Kosovën në këto bisedime, janë valide. Mendojmë se nuk është arritur ende asnjë kompromis dhe është mirë që herëve të tjera shkresat të formulohen së bashku me anëtarët e Komisionit.

Albin Kurti - Propozoi të procedohet sipas pikës së rendit të ditës “Njoftimi dhe raportimi i zëvendëskryeminstres Edita Tahiri për bisedimet me Serbinë” dhe e ftoi zëvendëskryeminstren ta merrte fjalën.

Edita Tahiri - Fillimisht shprehu shqetësimin për ftesën, në të cilën thuhet “kompromisin e bërë atje”, për të cilën tha se është paragjyquese, joserioze dhe as institucionale. Në cilësi të udhëheqëses së ekipit për dialogun teknik ndërmjet dy shteteve, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, shprehu gatishmërinë të raportojë në këtë Komision dhe në seancë plenare, sa herë të jetë e nevojshme, si dhe kur vlerësohet se ka çështje të rëndësishme për t’i ndarë me Komisionin. Qeveria e Republikës së Kosovës është bartëse e procesit të dialogut teknik me palën serbe, që bazohet në obligimin e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të 10 shtatorit 2010, në obligimin kushtetues të Qeverisë në ushtrimin e sovranitetit në çështjet e politikave të brendshme dhe të jashtme, në zotimet kushtetuese që Kosova do të kontribuojë për fqinjësi të mirë dhe për paqe e për stabilitet në rajon, në synimet për anëtarësim në BE, NATO, OKB dhe në institucione të tjera relevante. Mbi këtë bazë është marrë ky obligim ndërkombëtar dhe dialogu udhëhiqet nga një platformë e qartë, që i ka parimet, që i kemi definuar të dialogut teknik dhe parimet e panegociueshme në këtë dialog teknik. Bisedohet në bazë të platformës së Qeverisë, lidhur me telekomunikacionin, energjinë dhe do të bisedohet për transportin, për çështjen e të pagjeturve, për dëmshpërblimet e dëmeve të luftës, për demarkacionin e kufiri midis Kosovës dhe Serbisë, si dy shtete të pavarura, për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës, për targat e automjeteve, për mosnjohjen e diplomave, për mosnjohjen e vulave doganore dhe për bashkëpunimet rajonale. Dialogu do ta përshpejtojë rrugën drejt BE-së, kurse obligimi ynë është përmbushja e standardeve.

Pas raportimit të znj. Edita Tahiri, u shtruan shumë pyetje dhe u bënë komente nga deputetët: Shaip Muja, Donika Kada Bujupi, Sabri Hamiti, Enis Kervan, Amir Ahmeti dhe Albin Kurti, të cilëve iu përgjigj zëvendëskryeministrja.

Pas përfundimit të kësaj pike të rendit të ditës, në mungesë të kuorumit Komisioni vendosi që pikat e mbetura të shqyrtohen në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti